Bumbreku s'ësht mirë. Po dy bumbrek: shënojnë dy evlad ose dy miq. Po të enjtet trupi: të shtohet bereqeti. Po të qajë djersa; të shtohet shëndeti.

**Kur sheh vegla hekurore, baltore, dhogore, lëkurore, kashtore, ëndra ç' kallzon?**

Palla: shënon mbret edhe evlad. Arma: fuqi. Thika: pasuni, po nga ndonjëherë: hasmëri. Sëpata: nderim, po për tregëtaret: fitim. Terezija: regullim. Lopata: shërbim. Kazma: pasuni. Çekani: dituri, (po për të zotin: rizk). Saçi: ethe. Kapâni: hile, kazani: nënpunësi. Zil' e orës: luftim. Zil' e kafshëve dhe yzengjia: udhëtim. Burija: ftim. Kyçi shënon vajzën e pa martuar, edhe personin e mbesuar. Po të hapish kyç: të hapet risku. I burgosuri po të hapë kyç: shpëton. Krehëri: shënon shok të mirë. Po gërshëra s' del mirë. Sahati murat edhe evlat. Gruaja po të shohë ibrik: lint djalë. Qelqi, qypi, bardhaku, tasi, çanaku: koto shënojnë grua edhe shërbëtor.

Korita shënon atë mall që fitohet me mundim. Sëndyqi: grua edhe magazi. Aarabaja: evlad edhe nënpunësi. Djepi: del hajir. Për beqarët: martesë. Për gratë: lindje. Samari shënon grua edhe udhë. Gruaja po të shohë shtresën e thyerë: shërohet. Stapi: ësht shërbëtor.

Freja: shënon mall edhe dëgjim. Kamxhiku: murad edhe përparim, shala edhe këllëfi: martesë



edhe afrim, prej këllëfit e nxjera fishek: shënon evlat. Po prej kalit e nxjera shalë: pa fat; këpuc e vjetër a e grisur: varfëri. Këpuc e mirë: naltësi. Po të humbish këpucët: ke humbur rugën e drejtë. Kush gjen këpucë gjen të vërtëtën.

Zymbili; shënon grua. Rogozi: vise të nalta. Po e ndenjura në Rogoz se heqin mirë. Fshesa quhet shërbëtore.

**Kur sheh barame edhe gjëra të liga: ëndra ç' kuptim ka?**

Cili sheh verë, kumare, loja, fyella, kënga, saze, kolovajza: punën e ka erësirë të cilat dalin hidhërim edhe ç' nderim. E pira raki: del sëkelldi E para vehten a tjatrin lakuriq: ësht shumë liksht. këto shfaqen nga gjynahet që punohen ditën d. m. th. pasqyra e punimit të keq shumë herë të çfaqet po këtu që të heqish dorë. ZOTI mëshir plot turpet edhe gjynahet t' ona na i mbuloftë edhe në rrugën e drejtë qëllimet edhe punimet na i shtoftë Amín!

**Kur sheh vare, të vdekur ëndra ç' tregon?**

Kush sheh vare: nga gjynahet të bëj tobe. Kush sheh që vdiq dhe u ngjallë prapë: dëshira i mbarohet. Kush sheh të vdekurin që qanë ka vajtur me Imán. Po ta shohish që qesh: ka shpëtuar nga rebeshi. Kush sheh të vdekurin që ik: i shto-